

# Nxitja e aktiviteteve kërkimore aplikative në Kosovë



## FAQ

### A ka një vegëz të disponueshme për të aplikuar në këtë thirrje?

Projekt propozimi së bashku me buxhetin dhe të gjitha informacionet e kërkuara dhe dokumentet mbështetëse duhet të dorëzohen në:

 [applied-research-call@giz.de](mailto:applied-research-call@giz.de)

me titullin

 **“Aplikimi për Thirrje për Kërkim të Aplikuar - Emri i Aplikuesit”**

deri më 01/12 /2022 në orën 17:00 h.

### A ka udhëzime për këtë thirrje?

Jo, nuk ka asnjë udhëzim specifik për këtë thirrje.

Informacioni mbi një marrëveshje financimi me GIZ mund të gjendet në:

 <https://www.giz.de/en/workingwithgiz/34529.html>

### A përcaktohet numri se sa partnerë duhet të jenë pjesë e konsorciumit për të aplikuar?

Është e obligueshme të ketë një IAL publik së bashku me një kompani private mikro, të vogël apo të mesme. Është e mundur të përfshihen partnerë shtesë kërkimor, nuk është numri i kufizuar.

### A do të jetë e pranueshme të përfshihet si partner një shoqatë sektoriale biznesi, në vend të një shoqërie biznesi?

Jo, është e obligueshme të ketë një institucion publik i arsimit të lartë (IAL) së bashku me një shoqëri private mikro, të vogël ose të mesme. Mund të përfshihet gjithashtu një shoqatë sektoriale e biznesit.

### A mund të aplikojnë IAL-të private?

IAL-të private kanë mundësinë që së bashku të formojnë një konsorcium me një IAL publike dhe me një kompani private mikro, të vogël ose të mesme, por nuk kanë të drejtë të jenë përfitues i grantit.

### A mundet VentureUp si Qendër e Ndërmarrësisë dhe inkubator zyrtar i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të përfshihet në një projekt kërkimor apo edhe të shërbejë si përfitues i grantit?

Po. Megjithatë, kërkohet përfshirja e të paktën një departamenti/hulumtuesi nga një departament i universitetit.

### A është e mundur që t'i jepet më shumë se një grant të njëjtit IAL publik?

Ekziston mundësia, megjithëse dhënia e katër granteve varet nga vlerësimi i kryer nga një komision i pavarur vlerësues.

### A është i domosdoshëm zbatimi i projekteve kërkimore në ITP Prizren apo mund të përdoret infrastrukturë tjetër?

Mund të përdoret çfarëdo infrastrukture. Realizimi i projekteve kërkimore në PIT Prizren është i dëshiruar dhe mund të marrë mbështetje financiare shtesë (p.sh. renovimi i objekteve)

### A ka një përqindje maksimale buxhetore për kategoritë buxhetore si personeli?

Jo, por kostot e personelit duhet të jenë të arsyeshme.

### A është e mundur të buxhetohen "kontigjencat"?

Jo, "kontigjencat" nuk janë të pranueshme. Duhet të specifikohen të gjitha kostot e llogaritura.

### A është e mundur të përfshihet një marzhë fitimi?

Jo, grantet jepen mbi baza jofitimprurëse.